



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:243157

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06003771

KPPP.nr.1850/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare SH.A., me seli Prishtinë, rruga “Ukshin Hoti” nr.29, kundër debitorëve 1. “AGK” SH.P.K., me NUI: 811292870, me seli në Prishtinë, rruga “...” nr.40; 2. G.K., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...” nr.40; 3. K.Th., me vendbanim në Prishtinë, ... obj., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...” nr.32; 5. “Dafnos” L.L.C., me NUI: 810866147, me seli në Prishtinë, rruga “...” nr.40; 6. A.H.H. B.I., me NUI: 810913526, me seli në Prishtinë, rruga “...” nr.44/1; 7. E.K., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...” nr.40 dhe 8. A.K., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...” nr.... që të gjithë përfaqësuar sipas autorizimit nga F.K., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.1771/23 të datës 19.10.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. “AGK” SH.P.K., 2. G.K., 3. K.Th., 4. A.H., 5. “Dafnos” L.L.C., 6. A.H.H. B.I., 7. E.K. dhe 8. A.K., i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.1771/23 të datës 19.10.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbarimor P.nr.1771/23 i datës 19.10.2023, i Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbaresit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.1771/23 të datës 19.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarimore - Marrëveshja mbi Pengun Nr.9117/19 e datës 10.05.2019, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20190510-523 i datës 10.05.2019; Marrëveshja mbi Pengun Nr.9199/19 e datës 12.07.2019, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20190715-447 i datës 15.07.2019; Marrëveshja mbi Pengun Nr.9699/21 e datës 15.02.2021, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20210216-429 i datës 16.02.2021 dhe Marrëveshja mbi Pengun Nr.9699/21 e datës 27.04.2022, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20220518-377 i datës 18.05.2022, duke detyruar debitorin nga dita e dorëzimit të urdhrit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 226,784.20 €, duke përfshirë këtu edhe çdo detyrim tjetër që mund të bëhet i kërkueshëm dhe i arritshëm për pagesë deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të bëhet përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë për debitorët deri në realizimin e vlerës së borxhit, nëse debitorët nuk kanë mjete në llogaritë bankare atëherë përmbarimi të realizohet përmes sekuestrimit të kolateralit të cilin debitori e ka lënë peng.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kontrata me numër 9699/21, absorbon detyrimet nga kontrata e vitit 2019, përkatësisht detyrimet nga kontrata e vitit 2019 janë shuar. Tutje ka theksuar se garantuesi si debitor subsidiar nuk ka mundësi që t'i nënshtrohet procedurës përmbarimore në të njëjtën kohë me debitorin kryesor pasi që borxhi fillimisht duhet të kërkohet nga debitori kryesor. Sa i përket dokumentit mbi bazën e të cili është lejuar urdhri përmbarimor ka deklaruar se i njëjti nuk përbën dokument përmbares sipas nenit 22 dhe 27 të LPP-së, sipas këtyre dispozitave dokumenti i përmbarueshëm është dokumenti noterial në pajtim me ligjin e noterisë, po ashtu pengun duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e pengjeve, po ashtu nuk është e qartë as shuma e borxhit e cila kërkohet, nuk dihet mbi çfarë baze është përcaktuar, është e paspecificuar se për cilin detyrim bëhet fjalë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim si të pabazuara, në lidhje me deklaratimet e kreditorit se vlera e borxhit është e kontestueshme, nuk qëndrojnë për faktin se borxhi rrjedhë nga kontratat e kredisë të

nënshkuara nga vet debitorët. Tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorëve se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përbarimor nuk paraqet dokument të përbarueshëm, të njëjtat nuk qëndrojnë pasi që kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut paraqet titull ekzekutiv dhe është përcaktuar si dokument i përbarueshëm. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorëve, të vërtetoj urdhrin përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përbarues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentet përbaruese përkatësisht Marrëveshjen mbi Pengun Nr.9117/19 të datës 10.05.2019, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20190510-523 të datës 10.05.2019; Marrëveshjen mbi Pengun Nr.9199/19 të datës 12.07.2019, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e

pengun R-20190715-447 të datës 15.07.2019; Marrëveshjen mbi Pengun Nr.9699/21 të datës 15.02.2021, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20210216-429 të datës 16.02.2021 dhe Marrëveshjen mbi Pengun Nr.9699/21 e datës 27.04.2022, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20220518-377 të datës 18.05.2022, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenit nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, Marrëveshja mbi Pengun Nr.9117/19 e datës 10.05.2019, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20190510-523 të datës 10.05.2019; Marrëveshja mbi Pengun Nr.9199/19 e datës 12.07.2019, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20190715-447 të datës 15.07.2019; Marrëveshja mbi Pengun Nr.9699/21 e datës 15.02.2021, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20210216-429 të datës 16.02.2021 dhe Marrëveshja mbi Pengun Nr.9699/21 e datës 27.04.2022, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20220518-377 të datës 18.05.2022, si dhe të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuara.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1850/23, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.